



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



TARİH: DATË/A:	17.07.2013
REFERANS:REFERENC-Ë:	ZKF/019-13
KËME/PËR/ZA/TO:	Drejtorët e Drejtorive Kryesuesja e Kuvendit Komunal Komiteti për Politik dhe Financa Anëtarët e Asambles Komunale
CC:	z.Arif Bütuç-Kryetar i Komunës së Mamushës
KËMINÖNERËSIË/PËRMES/ PREKO/THROUGH:	
KËMDEN/NGA/OD/FROM:	Znj.Xhevahire Gashi, Zyrtare Kryesore Financiare, Komuna e Mamushës
KONU/TEMA/SUBJKAT/SUBJEKT:	Planifikimi i buxhetit/Qarkorja e Brendëshme Buxhetore Komunale 02/2014 dhe kalendari-final

Praktikisht procesi i planifikimit buxhetor fillon me Qarkoren Buxhetore 01 (këtë vit 2014/01 dhe 2014/02) që njofton për zhvillimin e procesit komunal buxhetor, kalendarin apo agjendën e planifikimit buxhetor komunal dhe procedurat e përcaktuara në ligjin për Financat Publike dhe Përgjegjësi.

Qështje me rëndësi në këtë fazë janë:

1. Kufijtë buxhetor të finacimit/burimet

- Me qarkoren buxhetore 2014/01 janë përcaktuar kufijtë e buxhetit sipas granteve buxhetore si:

Nr	Granti/Burimi	Vlera		Krahasimi
		2014	2013	
1	Granti i përgjithshëm	731,792.00	569,209.00	162,583.00
2	Granti specific i arsimit	346,806.00	327,127.00	
3	Mbulesa për mesimdhënesit në pushim mjekësor dhe të lehonive	9,144.00		
4	Total Granti i Arsimit	355,950.00	327,127.00	28,823.00
5	Granti specifik i shëndetsisë	121,867.00	107,999.00	13,868.00
6	Të hyrat vetanake	63,000.00	60,000.00	3,000.00
Total		1,272,609.00	1,064,355.00	208,254.00

- Me qarkoren buxhetore 2014/02 janë përcaktuar kufijtë e buxhetit për vitin 2013 sipas kategorive ekonomike, si më poshtë:

Stafi 2014	Paga Mëditje	Shpenzime operative (Mallra & komunali, subvencione)	Shpenzime Kapitale	Të hyrat vetanake	Totali
136	710,000.00	109,436.00	390,173.00	63,000.00	1,272,609.00

1.1 Detyrat për kufijtë buxhetor të financimit/burimit

1.1.1.-Formulimi i planifikimit për programin e arsimit (aprovimi i buxhetit për shkolla nga Këshilli i shkollës) dhe shëndetsisë dhe dërgimi te zyrtari kryesor financiar deri më datë 22.07.2013

1.1.2.-Dorzimi i dokumenteve të planifikimit për programet e mësipërme dhe verifikimi i përbashkët i tyre nga programi përkatës, zyrtarët e buxhetit dhe kryetari, datë 22.07.2013; ora 12:00.

1.1.3.-Dorzimi I tyre (pasqyrë e përshtatshme dhe formularët e planifikimit sipas formulës/kopje) nga zyrtarët përgjegjës te zyrtari kryesor financiar më datë 22.07.2013; ora 12:00.

2. Agjenda finale

Kjo agjendë është vendosur duke e përfshirë tërë agjendën sipas qarkorës buxhetore 2014/02. Agjenda përfshinë:

1. Planifikimi i buxhetit të programit nga drejtoritë përkatëse.
2. Planifikimi i shpenzimeve të programit (duhet të përfshihen me projekte përkatëse kategoria e shpenzimeve kapitale dhe mallrave dhe shërbimeve.
 - 2.1.-Shpenzimet kapitale duhet të jenë të përfshira me projektet kapitale të cilat duhet të përmbajnë informatat themelore si përshkrimi i përmbajtjes së projektit, kostoja totale, kostot kryesore të projektit, qëllimi, përfituesit e projektit, (për pikën 1 dhe 2 data e fundit datë 22.07.2013; dorzohen te zyrtari kryesor financiar), (vërejtje: nëse projektet nuk përmbajnë keto shënime nuk do të përfshihen në buxhet)
 - 2.2.-Shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve duhet të jenë të përfshira me projekte të cilat duhet të përmbajnë informatat themelore si përshkrimi i përmbajtjes së projektit, kostoja totale, kostot kryesore të projektit, qëllimi, përfituesit e projektit, (për pikën 1 dhe 2 data e fundit datë 22.07.2013; dorzohen te zyrtari kryesor financiar)(vërejtje: nëse projektet nuk përmbajnë keto shënime nuk do të përfshihen në buxhet)
3. Takim pune me kryetarin, drejtorët, (25.07.2013).
4. Takim pune me kryetarin, drejtorët, komitetin për politikë dhe financa, komitetet tjera dhe palët tjera të interesuara (deri më 30.07.2013).
5. Harmonizimi i projektit të shpenzimit me objektivat dhe qëllimet strategjike të strategjisë zhvillimore të komunës (deri më 30.07.2013).
6. Plani i Buxhetit për vitin 2014 - 2016 nga Zyrtari Kryesor Financiar (deri më 31.07.2013)

7. Mbajtja e takimeve me grupet e interes (minimum tre takime) në karakterin e dëgjimeve publike apo takimeve të punës nga secili program i buxhetit apo për projekte të veqanta nëse është e nevojshme (takimet duhet të jenë të dokumentuara zyrtarisht) (deri më 01.08.2013).
8. Mbajtja e dëgjimeve publike nga kryetari dhe sektortori i buxhetit dhe Komiteti për politik dhe financa (minimum 3 takime), nga 01 Gusht -02 shtator, 2013).

Qarkorja e Brendshme Buxhetore Komunale 02/2014 - Kalendar Final

Nr	AKTIVITETI	PËRGJEGJËSIA	AFATI I FUNDIT
1	Shpërndarja e Qarkorës 2014/02	Departamentet	17 Korrik
2	Nxjerrja e Qarkores Buxhetore 02/2014	ZKF	17 Korrik
3	Dorëzimi i Buxhetit tek ZKF	Departamentet	22 Korrik
4	Rishikimi I buxhetit të propozuara	ZKF	24 Korrik
5	Takim pune me Kryetarin dhe Drejtorët e departamenteve	ZKF	25 Korrik
6	Takim pune me kryetarin, drejtorët, komitetin për politikë dhe financa, komitetet tjera dhe palët tjera të interesuara	ZKF	Deri më 30 Korrik
7	Organizimi		
8	Plani i Buxhetit për vitin 2014 dhe projektionet 2015, 2016	ZKF	31 Korrik 2013
9	Mbajtja e dëgjimeve publike nga kryetari dhe sektori i buxhetit (minimum 3 takime)	Organizimi:nga Komiteti për Politik dhe Financa Prezentimi:nga Kryetari	nga 01 Gusht - 02 shtator, 2013
10	Dorëzimi I buxhetit të propozuar dhe vlerësimet për dy vitet e ardhëshme	Komiteti për Politik dhe Financa	18 Shtator 2013
11	Rishikimi,modifikimi dhe aprovimi i buxhetit	Asamble	25 Shator 2013
12	Dorëzimi i buxhetit të propozuar në Ministrin e Financave - Departamenti i Buxhetit Komunal	ZKF	30 Shtator 2013

Vërejtje:

1. Të gjitha projekte kapitale duhet të jene të arsyetuara në vlerë dhe arsyeshmëria e projektit.
2. Për të gjithë hapat, detyrat eventual që dalin jashtë këtyre hapave, do të jeni të njoftuar zyrtarisht me email apo formë tjetër zyrtare.